



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR.4184 Regj.Them
Date rregj.20.09.2018

Date vendimi 25.10.2018

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR: Ahmet METALIAJ

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Gentiana SADIKU, sot me dt.25.10.2018, në Tiranë, mori shqyrtimin ne seancë gjyqësore publike kërkesën penale, qe i perket:

KERKUES: B. A., i biri i F. dhe N. ,i datelindjes 30.11.19.., lindur ne Tirane dhe banuese ne Paskuqan, në mungesë,mbrojtur nga përfaqësueset me prokurë,nga Av.Emiljana Kane me nr.7987 license, NIPT L61503028 M dhe Av.Blerina Dodaj me nr. 6419 license , NIPT L32130004 T, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI: Ndryshimin e vendimit te Prokurorise Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te dates 24.07.2018.

PERSON I INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
BAZA LIGJORE: Neni 210-212 e në vijim i Kodit të Procedures Penale.

Gjykata pasi bëri verifikimin e paraqitjes së palëve, dëgjoi ato të cilat në përfundim kërkuan:

Përfaqësuesen me prokurë të kerkuesit,Av.Blerina Dodaj, e cila në diskutimet përfundimtare kërkoi:

Pranimin e kërkesës.

Ndryshimin e vendimit të prokurorit për sekuestrimin e llogarive bankare të Z.B. A..

Kërkuesi B.A., Në mungesë.

Prokurori , i cili në diskutimet përfundimtare kërkoi:

Rrëzimin e kërkesës.

Lënien në fuqi te vendimit të prokurorit për vënien sekuestro të llogarive bankare të regjistruara në emër të shtetasit B. A..

Pasi u shqyrtuan pretendimet e mësipërme të palëve, si dhe të gjitha faktet dhe provat e shqyrtuara e të administruara në seance gjyqesore, në fashikullin e gjykatës;

VEREN SE:

Se, nga kërkuesi i denuari B. A. ka paraqitur në Gjykatë për gjykim një kërkesë me nr. 4184 Regj. Them datë 20.09.2018 me anën e të cilës ka kërkuar:

Ndryshimin e vendimit të Prokurorisë Prane Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, të datës 24.07.2018 (Heqjen e Sekuestros)

Nga ky shqyrtim gjyqësor, bazuar në faktet dhe provat e marra e të administruara në seance gjyqesore, pjesë e fashikullit gjyqësor, ka rezultuar si mëposhte:
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, ka regjistruar procedimin penal Nr.2991/2018, për Veprën Penale të "Mashtrimit", të parashikuar nga neni 143/3 i K. Penal.

Organi i Akuzës, Tirane, gjatë fazës së hetimeve paraprake, për llogaritë të këtij procedimi penal, me vendimin e datës 24.07.2018 "Për sekuestron e provës materiale" ka vendosur:

Te sekuestronj (bllokoj) menjëherë llogaritë bankare të regjistruara në emër të shtetasit B.A., i biri i F. dhe i N., i datelindjes 30.11.19.., lindur dhe banues në rrugën "...", kompleksi "...", kati i katërt, pallati nr 1., njesia Administrative ..., Bashkia Kamze, me kombësi shqiptare dhe shtetesi shqiptare i dyshuar për veprën penale të "Mashtrimit me pasoja të rënda i kryer në bashkëpunim në dem të shtetasit T. M.", të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

Për kryerjen e këtij veprimi ngarkohet banka perkatese e cila duhet të mbaj dhe proces-verbalin perkatese.

Për kryerjen e këtij veprimi të njoftohet menjëherë Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim i organit të akuzës Tirane, është argumentuar dhe justifikuar me shkakun se nga shtetasi B. A. rezulton se ka realizuar mashtrimin nëpërmjet kontratës së datës 18.08.2017 ku ka vënë garant sipërfaqje toke 61.290 m² nga B. A. pronë e cila është e regjistruar në emër të babait të tij si dhe referuar deklaratimeve të administruara në fashikull dhe kjo rezulton e zënë nga dy banesa të dy shtetasve të tjerë që kanë të njëjtën problem me shtetasin B. A. është thjesht për të mashtruar shtetasin T. M..

Për sa sipër mbështetur në provat e administruara arrihet në konkluzionin se janë konsumuar elemente të veprës penale të "Mashtrimit", parashikuar në nenin 143/2 i kodit penal nga shtetasi F. K. dhe B. A. pasi që nga viti 2013 e në vijim nuk janë respektuar asnjëherë afatet e shlyerjes së huasë së dhënë nga shtetasi B. A. shtetasit F.K.. Paratë janë marrë nëpërmjet mashtrimit dhe shpërdorimit të besimit. Viktima e veprës penale është joshur nga dy mashtruesit të cilët pasi i kanë marrë të hollat viktimes i kanë tjetërsuar edhe pronën e paluajtshme që ky shtetas duhet të përfitonte në bazë të kontratave, Pra që në fillim të dy mashtruesit kanë pasur si qëllim marrjen e pasurisë së luajtshme nga viktima dhe me pas të vazhdonin veprimet fiktive gjoja sikur do të jepnin pronën të paluajtshme viktimes, në një kohë që pronat e paluajtshme ishin tjetërsuar (kishin avulluar). Kjo tregon edhe një herë se jemi para veprës penale të "Mashtrimit" e kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 143 të

Kodit Penal dhe duke qënë se kemi edhe pasoja të rënda jemi në rrethana të cilesuara në paragrafin e tretë të nenit 143 të Kodit Penal. Vlen për t'u theksuar se shtetasi B. A. për të maskuar veprimet e tij ka bërë edhe ai kallezim penal në një kohe që është vete mashtrues.

Është ky person i cili ka mashtruar në bashkepunim me shtetasin F. K. viktimen T. M..

Në këto kushte duhet t'i sekuestrohet (bllokohen) llogaritë bankare pranë bankave të nivelit të dytë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në emër të shtetasit B. A..

Ky vendim, i organit të akuzës, është ankimuar në Gjykatë.

Për sa mesiper, duke ju referuar dispozitave ligjore në bazë të të cilave është marrë ky vendim, kërkojmë nga ana e Gjykatës ndryshimin e vendimit të Prokurorisë Prane Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, datë 24.07.2018 duke parashtruar rrethanat e mëposhtme:

Është një vendim i paarsyetuar është një vendim i pavlefshëm dhe çdo provë e marrë në kundërshtim me ligjin nuk përbën provë. Edhe norma të tjera të cilat lejojnë sekuestrimin siç është sekuestro konservative dhe ajo preventive, nuk janë në rastin në fjalë shkak për të vijuar me vendosjen e një sekuestroje, pasi njëra është për garanci të ekzekutimit të gjobes apo të ndonjë detyrimi civil si dem i vepres penale dhe të sekuestro preventive është për të parandaluar qarkullimin e produkteve të vepres penale dhe për të identifikuar mjetet e kryerjes së veprës penale.

Asnjë nga këto raste nuk është, si edhe pasoja e ardhur nuk parashikohet në asnjë ligj edhe për detyrime civile që paga e një subjekti të bllokohet e tëra dhe të mos mundesohet aksesimi në llogarinë bankare.

Origjina këtyre të ardhurave të cilat janë të bllokuara nga prokuroria, është tërësisht e ligjshme, e deklaruar dhe e pastër në aspektin penal. Nuk është paga e B. A., produkt i veprës penale dhe as mjet i kryerjes së vepres penale, prandaj nuk ka asnjë shkak për këtë veprim për sekuestro.

Ndër të tjera, kërkojmë të merrni në konsideratë edhe rrethanat në lidhje me rastin në fjalë, siç janë ato familjare, pasi z.B. A. është kryefamiljar, ka femijë për të mbajtur, punon gjithë kohës për ekonominë familjare dhe është i angazhuar në detyrimet e tij për të gjithë konfliktin që është përfshirë dhe sekuestrimi i bërë i ka shkaktuar akoma me shumë vështirësi në jetesën e tij.

Pas shqyrtimit të plotë të të gjitha provave shkresore të administruara në këtë gjykim, bazuar në të gjitha faktet, rrethanat konkrete dhe shpjegimet e të dyja paleve ndërgjyqëse, i kërkuam Gjykatës përfundimisht: Përfaqësueset e kerkuesit - Pranimin e plotë të kesaj kerkese, sipas objektit të saj, ndërsa prokurori rrezimin e saj,

Gjykata ka arritur në konkluzionin se kërkesa e paraqitur nga Përfaqësueset e kerkuesit është e pabazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet të rrezohet për sa mëposhtë:

BAZA LIGJORE – LIGJI I APLIKUESHEM:

Neni 210 i K.Pr.Penale

“Sekuestrimi pranë bankave”
(Shtesë në pikën 1 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)

Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

Neni 212 i K.Pr.Penale

“Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit”
(Ndryshuar me ligjin 35/2017)

I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërimit të tyre, mund të bëjnë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve.

Kundër vendimit të Gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve .Gjykata e Apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve.

3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

Pra bazuar ne dispozitat e sipercituara, sekuestro mund të vendoset vetëm në rastet kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, organi e ka akuzuar kërkuesin B. A., si i dyshuar për veprën penale të "Mashtimit me pasoja të rënda i kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit T. M." ,të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

Gjykata çmon dhe arrin në perfundimin se vendimi i prokurorit per venien në sekuestro në lidhje me llogarite bankare të rregjistruara në emër të kërkuesit B. A. është krejtesisht drejtë, e i bazuar si ne prova ashtu edhe në ligj.

Përfaqësueset e kerkuesit gjatë gjykimit nuk sollën asnjë provë bindëse për gjykatën, përveç një kontratë individuale pune të lidhur ndermjet OSHEE dhe kërkuesit B. A.por nuk përcaktuar se në cilën bankë depozitohej paga.

Organi i Prokurorisë konfirmoi se në zbatim të pikës 3 të vendimit datë 24.07.2018 asnjë nga bankat nuk e ka njoftuar këtë organ për zbatimin e këtij vendimi.

Perfundimisht, Gjykata ka arritur ne perfundimin se, kerkesa dhe ne teresi pretendimi i ngritur nga kerkuesi B. A., bazuar ne aktet dhe provat te pretenduara si të tilla nga pala kerkuese, të shqyrtuara dhe te administruara me cilesine e proves shkresore në seance gjyqesore, rezulton te jete e pa mbeshtetur në prova dhe ne ligj dhe si e tille kjo kerkese duhet te rrezohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 208-210-212-217-218 të K.Pr.Penale (i ndryshuar)

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës me Nr. 4184 Rregj.Them, datë ardhje 20.09.2018, me kërkues B.A., si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Shpenzimet gjyqesore në ngarkim të kërkuesit.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall në Tiranë, sot me datë 25.10.2018.

SEKRETARE

Gentiana SADIKU

GJYQTAR

Ahmet METALIAJ

**